



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

29.10.2012

Titulli i Dokumentit	Numri i Serisë	Drejtori	Vlera
	01-013/1275		

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenin 15 dhe 16 lidhur me nenin 13 dhe 14 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr 2003/14 dhe në bazë të dispozitave të nenit 11 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit për Planifikimin hapësinor nr 2003/14, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për elementet themelore të Planit Rregullues Urban nr pr 02/05 nr rendor 41 si dhe nenit 17 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28, dhe nenit 11.2.2 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01- 013/491 të datës 21.04.2011, dhe mbështetur në kriteret e Planit Zhvillimor Urban të Komunës së Vitisë, të datës 28.12.2010 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2012 aprovon këtë:

## V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN PËR ZONAT: QENDRORE, JUGORE DHE LUMIT MORAVA” TË QYTETIT TË VITISË

I.

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë APROVON Planin Rregullues Urban për zonat: Zona Qendrore, Zona Jugore dhe Zona e Lumit Morava e Binçes të qytetit të Vitisë, me një sipërfaqe të përgjithshme prej S= 94.97 ha.

II.

Organi kompetent ka zbatua të gjitha procedurat ligjore të cilat dalin nga Vendimi për hartimin e Planit Rregullues Urban për qytetin e Vitisë me nr 01-013/332 të datës 17.03.2011.

III.

Plani Rregullues Urban do të shqyrtohet çdo pesë vjet dhe nëse është nevoja do të ndryshohet.

IV.

Plani Rregullues Urban përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mjedis, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Inspektion, dhe Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Vitisë.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi i dërgohet:

1. Drejtorisë për Urbanizëm,
2. Drejtorisë për Gjeodezi,
3. Drejtorisë për Inspektion,
4. Drejtorisë për shërbime Publike dhe
5. Arkivit,



KRYESUESI I KUVENDIT  
Skenderbe Hebibi

*Skenderbe Hebibi*